



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

317
Nr. ___ Prot.

Tiranë, më 30. 6. 2017

V E N D I M

Nr. 15, datë 30 qershor 2017

“Mbi amendimin e Statutit të ASH-së dhe hapjen e 6 fushave për “anëtarë të rregullt të ASH-së”

Në zbatim të ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006 « Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë », të Statutit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Asambleja e Akademisë së Shkencave, në mbështetje të rendit të ditës të propozuar nga Kryesia dhe të aprovuar nga Asambleja, në mbledhjen e saj të datës 30 qershor 2017;

V e n d o s i:

1. Të aprovojë ndryshimet në STATUTIN e ASH-së sipas propozimeve bashkëmbyllur, të hartuara nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryesisë së ASH-së për këtë qëllim.
2. Amendimet e Statutit hyjnë në fuqi menjëherë dhe këto ndryshime të reflektohen në dokumentin e STATUTIT të publikuar në web dhe në të gjitha kopjet e tij që përdoren nga ASH-ja.
3. Të aprovojë hapjen e 6 (gjashtë) fushave për “anëtar të rregullt” të ASH-së sipas propozimeve bashkëmbyllur.
4. Kryesia e ASH-së, konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të përgatisë dhe publikojë “Thirrjen për pjesëmarrje” dhe kriteret, drejtuar akademikëve të asociuar për periudhën 3-17 korrik 2017.
5. Mbledhja e radhës për votimin e kandidaturave të paraqitura, konform ligjit, do të zhvillohet më datën 4 shtator 2017 në sallën “Aleks Buda” të ASH-së, ora 11.00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
MUZAFER KORKUTI

M. Korkuti



Fushat e propozuara nga Kryesia për Asamblenë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Gjuhësi

Sociologji

Drejtësi

Kimi

Biologji

Mjekësi